REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 864/19
Datë/Datum. 02.12.2019
PRISHTINË - PRIŠTINA

ANKESË

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për:Organi Shqyrtues i Prokurimit

Për Aktivitetin e Prokurimit: Nr. i AP: ***616-19-1655-2-2-1 nr.brend. 616 19 051 221***

Sa i përket tenderit për ***"Dezinfektimi, dezinsektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore"***

1. Identifikimi i ankuesit*

Besim A.Zejnullahu B.I – "N.SH.EKO - DDD"
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Regakut.p.n
(Adresa)

Ferizaj — *70000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044138490 —
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Besim Zejnullahu
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
ekoddd@hotmail.com
(Adresa elektronike)

02.12.2019
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- *Njoftimi per kontrate dt.05.04.2019*
- *Afati i fundit per dorezim te tenderit dhe hapje te tenderit 25.04.2019*
- *Njoftimi per vendimin per dhenje te kontrates 19.11.2019*
- *Tenderi i pergjegjshem me Çmim me te ulet*
- *Njoftimi për dhënie të kontratës dhe letrën standarde për tenderuesit e pa sukseshëm pas ri-vlersimit,me dt.19.11.2019*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po					Jo	x	

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po	x				**Jo**	

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po	x				**Jo**	

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Pas pranimit te Letres standarde per tenderuesin e pasuksesshem dhe Vendimin e AK per shperblim me kontrate ne afatin e lejuar kemi bere Kerkese per Rishqyrtim te Vendimit me daten 22.11.2019 te AK.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- **Neni 1,**
- **Neni 7,**
- **Neni 28,**
- **Neni 56.3,**
- **Neni 59,**
- **Nenit 69,**
- **Neni 72 dhe**
- **108A të LPP-ës.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I paknaqur me Vendimin e AK te pranuar me daten 26.11.2019 ne lidhje me projektin ***Dezinfektimi, dezinsektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore" me nr. Prok. 616-19-1655-2-2-1*** në afatin e lejuar ushtroje këtë

ANKESË

-Vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe

-Shkelje esenciale të dipozitave të LPP-së

Menjëherë pas pranimit të letrës standarde dhe Njoftimin për Vendim-Shpërblim me kontratë kemi kërkuar nga AK qasje në dokumentacionin e OE të rekomanduar për kontratë pasi kemi pasur dyshimet tona të bazuar që i njejti është i papërgjegjshëm i cili nuk i ka-plotësuar kërkesat e kërkuara me DT.
Me datën 19.11.2019 na është lejuar që të kemi qasje në dokumentacionin e OE të rekomanduar për kontratë edhe pas kontrollit dyshimet tona u plotësuan pasi i njejti nuk i plotëson kriteret e kërkuara.
Po ashtu në Raportin e Vlerësimit të Tenderëve në faqe 14, **tek Konstatimi lexuam që AK ka shënuar që OE VLERA SHPK nuk është i përgjegjshëm por meqenëse OSHP ka marrë vendim që të pranohet si ofertë e përgjegjshme AK e rekomandon për dhënje të kontratës vetëm në pajtim me vendimin e OSHP-së.**

Në bazë të vendimit të OSHP-së me nr. PSH.nr. 523/19 dhe PSH.nr.315/19 ne nuk kemi pa se OSHP ka dhënë urdhëresë që të pranohet si ofertë e përgjegjshme por që lënda të kthehet në rivleresim dhe AK mund të kërkojë sqarime nga OE për cfarëdo dëshmie që konsideron se nuk është sipas dosjes së tenderit.
Po ashtu është shumë me rëndësi se në Vendimin e OSHP-së 523/19 Paneli shqyrtues ka konstatuar gabim sa i përket çmimit të ofertës me 2 numra pas pikës dhjetore, pasiqë në **Dosje të Tenderit është shumë mirë e cekur në faqe 7, pika 20.- Valuta dhe Kalkulimi i cmimit**
20.1 Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro (€) dhe duhet të përfshinë të gjitha taksat e aplikueshme, detyrat dhe pagesat tjera. Çmimi i ofertuar lejohet qe te shenohet me maksimum dy (2) numra pas preses dhjetore. **Çdo numer i shenuar pas numrit te dyte (2) nuk do te merret per baze ne llogaritje te vleres se ofertes**
Pasiqë kjo është e cekur në Dosje të Tenderit OE VLERA SHPK nuk ka ofertuar sipas Dosjes së Tenderit.

Po ashtu në vendimin e njejtë të OSHP-së ceket se çmimi total i OE VLERA SHPK me TVSH është 10736.97 dhe se ky çmimi është marr nga procesverbali i hapjes, por me raportin të cilin Ne posedojmë dhe i cili është në platformën elektronike ky cmim nuk figuron fare. Shihet qarte se këtu është bërë ndonjë gabim.

Në bazë të Dosjes së tenderit te Specifikimet teknike të dërguar në platformen elektronike me datën 12.04.2019 është kërkuar që të ketë së paku një Epidemiolog dhe një teknik sanitar, për të cilët kërkohen dëshmitë: **Diploma, CV, Kontrata e punës dhe licenca e punës valide.**
Grupi i operatorëve VLERA SHPK dhe EKO DEZ DOO nuk kane plotësuar këtë kriter dhe në ofertën e tyre edhe ne kemi verifikuar posedimin dhe mosposedimin e dokumenteve si në vijim:

Stafi profesional Nga VLERA SHPK	**Diploma/ certifikata**	**CV**	**Kontrata e punes**	**Licenca e punes**
EPIDEMIOLOG Ekrem Sogojeva -	Posedon	Mungon	Posedon	Mungon
TEKNIK SANITAR	Mungon	Mungon	Mungon	Mungon
Stafi profesional Nga EKO DEZ DOO	**Diploma/ certifikata**	**CV**	**Kontrata e punes**	**Licenca e punes**
EPIDEMIOLOG	Mungon	Mungon	Mungon	Mungon
TEKNIK SANITAR	Mungon	Mungon	Mungon	Mungon

EKO DEZ DOO posedon një listë të stafit prej 20 personave të cilët kanë kryer një trajnim një ditor për DDD, ndërsa VLERA SHPK posedon 10 teknik veterinar, një mjek veterinar dhe një agronom të cilët nuk janë kërkuar fare në këtë projekt.

Në bazë të ligjit te MINISTRIA E SHENDETESISE/UDHEZIMI ADMINISTRATIV Nr.10/2011 REXHISTRIMI DHE LICENCIMI I PROFESIONISTEVE SHENDETESOR, në bazë të Nenit nr.2 dhe Nenit nr.8 obligohen të gjithë profesionistët shëndetësorë që të licencohen dhe rilicencimi i tyre bëhet vetëm nëse i plotësojnë kuotën e nevojshme të pikave krediduese të parapara me aktet e Bordit për Zhvillim të Vazhdueshëm Provesional.

PAISJET:
Në bazë të kontrollimit të dokumenteve ne kemi analizuar , është vertetuar kriter tjeter që nuk kan plotësuar grupi i operatorëve VLERA SHPK dhe EKO DEZ DOO është mosposedimi i paisjve. Të njejtin ka ofruar shumë paisje tjera dhe të gjitha në pronësi te EKO DEZ DOO por jo ato që kërkohen në Dosje të tenderit.
Në bazë të Dosjes së tenderit Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale paisjet të cilat kërkohen dhe për të cilat janë gjetur se mungojnë paisjet si dhe dëshmia e posedimit (Faturë dhe DUD) nga grupi i operatoreve VLERA SHPK dhe EKO DEZ DOO jane si në vijim:

Emri i paisjes	Posedimi	Dëshmia
Min 3 pompa ULV ELEKTROSTATIKE	JO	Mungon
.Min 3 pompa ULV – ELEKTRIKE	JO	Mungon
Pompë me bateri për spërkatje 3 copë	JO	Mungon
Min një Pajisje që krijojnë avull të nxehtë me temperaturë deri 180 ^{0}C për eliminimin e insekteve me detergjent përkatës .	JO	Mungon

Sqarime shtesë për PAISJET e prezentuara nga ana e grupit të VLERA SHPK dhe EKO DEZ DOO

Te Deklaratata e Paisjeve grupi i OE VLERA SHPK dhe EKO DEZ DOO kanë ofruar gjithsej 62 faqe:
-Te Deklarata e Pasisjeve, paisja me **numër rendor 1, 3,6** kanë ofruar fatura për 6 paisje **U 15 HD-M ULV** (fatura me nr 1179 të datës 15/06/2004;.91-3268 të datës 11/07/2007; fatura me nr 63-4506 të datës 13/11/2009; fatura me nr 59-2050 të datës 22/05/2009).Ne faqen 7 dhe 8 ka ofruar një pasqyrë të paisjeve (fotografuar nga telefoni) ku edhe këtu nuk figurojnë .asnjë paisje e kërkuar.
Paisjet e tilla te ofruara janë paisje që peshojnë 166 kg, e zbrazur , me dimenzionet 87x79x 91 vendosen në kamioneta dhe përdorën vetëm për Dezinsektime Hapsinore (sipërfaqe të jashtme), ku OE ka ofruar dëshmi me foto dhe specifikacion të kësaj paisje gjatë dezinsektimit hapsinor diku në Serbi si në faqet **49,50,51,52,53,54,56,57** -Për me teper argumente bindëse shiqoni edhe specifikacionin e këtyre paisjeve të ofruar nga prodhuesi i ketyre paisjeve IGEBA ,gjithashtu edhe shitesi SAGA në Sebi që ja ka shitur kompanisë EKO-DEZ DOO keto paisje :
dokumente: http://www.unipro5.com/downloads/SERB/U10M_serb.pdf dhe https://www.igeba.de/en/products/ulv-aerosol-generators/u-15-hd-m/

-Te Deklarata e Pasisjeve- te paisja me **numër rendor 2** OE ka shënuar **TF 35/5 term generator ULV-EL**- ndërsa ka ofruar Faturën me numër 91 -3268 të datës 11/07/2007 ku është e shënuar **TF 35/5 TERMALNI GENERATOR** (emri i pasijes në liste me atë të faturës nuk janë të njejtë). Me këtë dëshmohet se **OE ka tentuar të bëjë mashtrim para komisionit vlerësues**, gjithashtu këto paisje punojnë me avull të nxehtë ku pesticidet përzihet me dizel, mazut ose ujë dhe motori i kësaj paisje punon me benzinë dhe përdoren vetëm për dezinsektime hapsinore dhe në asnjë mënyrë nuk guxojnë të përdorën në hapësira të brendshme e sidomos në Institucionet

shkollore e parashkollore. Gjithashtu në ofrojmë edhe deshmin specifikacionin e kësaj paisje nga prodhuesi i kësaj paisje IGEBA
Për më tepër https://www.igeba.de/en/products/thermal-fog-generators/tf-35/ dhe https://www.igeba.de/en/products/knapsack-sprayers/

-Te Deklarata e Pasisjeve, paisja me numër rendor **4 dhe 5** OE ka shënuar **ULV bat 12 volet** dhe **ULV** –por ,për këto paisje nuk ka ofruar asnjë dëshmi të posedimit (Fature, DUD apo marreveshje me qira) edhe këtu dëshmohet se **OE ka tentuar të bëjë mashtrim para komisionit vlerësues.**

-Te Deklarata e Pasisjeve, paisja me numër rendor **7** OE ka shënuar Foger k-22, ka ofruar vetem specifikacionin e paisjeve K 22 dhe K-30 Bio, nuk ka ofruar asnjë dëshmi të posedimit (Fature, DUD apo marreveshje me qira). Gjithashtu duhet cekur se këto paisje përdoren vetëm për dezinsektime hapsinore, si dëshmi OE për këto paisje ka ofruar specifikacion e këtyre paisjeve faqe 58,59,60
Gjithashtu brenda këtij fajli OE nga faqja 9 deri te faqja 48 ,ka bashkangjitur dokumente për automjetet e punës si polisat e sigurimit , librezat e qarkullimit të automjeteve dhe lejet e vozitjes që nuk janë kerkuar në këtë dosje të tenderit.

ANDAJ ASNJË PAISJE E OFRUAR NGA GRUPI I OPERATORËVE "VLERA" SHPK DHE "EKO DEZ DOO "NUK KAN TË BËJNË ME KËTË PROJEKT PASIQË VEPRIMTARIA E KËTIJ PROJEKTI ËSHTË KRYERJA E SHËRBIMEVE TË DDD NË HAPSIRAT E BRENDSHME SHKOLLORE.
SI DO TË MUND TË REALIZOHET KY PROJEKT, KU GJITHASHTU PO SHIHET, DËSHMOHET DHE ARGUMENTOHET EDHE ME DOKUMENTE PERCJELLËSE PËR TË GJITHA PAISJET

Ne kemi kerkuar nga AK qe zyrtarisht të kërkohen Sqarime dhe dëshmitë nga OE EKO DEZ për secilën paisje veq e veq të cilat janë të listuara në deklaratën e paisjeve e cila është përpiluar në gjuhën shqipe dhe serbe dhe e nënshkruar dhe vulosur nga OE EKO DEZ, por kjo nuk ndodhi, pasiqe AK nuk e mori parasysh kerkesen tone per rivlersim.

PRODUKTET (PREPARETET)
Në bazë të Dosjes së tenderit SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESHME për produktet të cilat kërkohen dhe për të cilat janë gjetë se mungojnë dokumente nga grupi i operatoreve VLERA SHPK dhe EKO DEZ DOO janë:

Emri i produktit te ofruar nga VLERA SHPK dhe EKO DEZ DOO	**1.Certifikata e A-testit**	**2.Lista teknike e sigurise**	**4.Leja nga Ministria perkatese**
PËR DERATIZIM			
Rodenticid	Mungon	Posedon	Posedon
Pllaka ngjitese per minje me arome	Mungon	Mungon	Mungon

PËR DEZINSEKTIM			
Preparate ne forme gelli	Mungon	Mungon	Mungon
Preparate qe treten ne uje	Mungon	Posedon	Posedon
PËR DEZINFEKTIM			
Preparate per dezinfektim	Mungon	Posedon	Nuk kerkohet ne DT

Sqarim lidhur me preparatet(produktet):

Grupi i operatoreve VLERA SHPK dhe EKO DEZ DOO te :
a)Atestet e Dezinfektimit ka ofruar:MSDS për produktin dezinfektues Benzalkonium Chlorit (faqe 2-8); MSDS për produktin dezinfektues Calcium Chlorid (faqe 9-17 dhe MSDS për produktin dezinfektues Isopropil alkool (faqe 18-26); Hydrogen Peroxide, 3% faqe (103-110)
Te produktet per Dezinfektim OE të gjitha dokumentet e tilla i ka shkarkuar nga interneti por te këto produkte MUNGOJNË CERTIFIKATAT E A-TESTIT (ANALIZAVE)-që dëshmojnë për cilësin dhe efektin e perdorimit të këtyre produkteve .

b) Atestet e Dezinsektimit (faqe 27), MSDS të një produkti ECHA(faqe 28);MSDS per një produkti cipermetrin(faqe 29); MSDS për produktin Aqua reslin super (faqe 30-41) ,gjithashtu për të njëjtin produkt ka ofruar etiketen dhe specifikacionin duke dëshmuar edhe me fotot e preparatit nga prodhuesi shiqo faqet 42,43,44 ,45,46 që mbasi është produkt rezidual që zakonisht perdoret për sipërfaqe të jashtme; në faqe 47 ka ofruar nje certifikat ISO për një kompani Turke Aydin Kimya Sanay ve ticaret A.S ;faqe 48 49dhe 50 ka ofruar Lejen nga MMPH me nr 1352-2/18 per keto produkte :Rodif pasta 100 dhe 200 gr rodenticid),Zinon Titan Tox 100 gr (insekticid pluhur) , Zinon Titan Super ME 50ml, 100 ml dhe 500 ml (insekticid qe tretet ne ujë),Zinon Emulzion 100 ml(insekticid qe tretet ne ujë), Zinon EW 50 ml(insekticid qe tretet ne ujë);nga faqja 51-76 ka ofruar MSDS per produktin Zinon EW disa ne gjjuhen angleze dhe disa ne gjuhen turke .
Te produktet Dezinsektuese te preparetet në formë gelli mungojnë të gjitha dokumentet e kërkuara si :Certifikata e Atestit,Lista e sigurisë teknike (MSDS) dhe leja nga MMPH ,gjithashtu te preparetet që treten në ujë mungon Certifikata e Atestit.

c) Atestet e Deratizimit (faqe 77) ; listet e sigurise teknike per produktin Ratmodez parafinski mamamac (faqe 78-83) dhe Ratmo dez rastresiti mamac (faqe 84-89);nje Autorizim per produkte në mes dy OE i cili është pa datë dhe i dyshuar per falcifikim (faqe 90); dhe një kontrate ne mes te ketyre OE te nenshkruar me 19/03/2012 (faqe 91-97); një fature e OE EKO-DEZ qe ka blere produkte nga nje

kopani tjeter ECO PEST DOO (faqe 98);foto nga telefoni per disa produkte (faqe 99); metedologjin e punes (faqe 100-102)

Te produktet për Deratizim mungon :Cetrifikata e Atestit për produktin deratizues gjithashtu për produtin Pllaka ngjitese për minje me arome mungojne të gjitha dokumentet e kerkuara si :Certifikata e Atestit,Lista e sigurise teknike (MSDS) dhe leja nga MMPH

SQARIM PËR PRODUKTET

OE për të dëshmuar cilësin, efikasitetin dhe sigurinë për njerzit (fëmijët) dhe ambientin brenda objekteve përveq që nuk ka ofruar dëshmitë për disa produkte si Certifikatë të Analizave dhe Listen Teknike të Sigurisë, gjithashtu nuk ka sjellur edhe dëshmitë nga Ministria përkatëse (MMPH).

Në bazë të ligjit për produkte biocide Nr.03/L-119 nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor (MMPH), asnjë produkt biocid në teritorin e Republikës së Kosovës nuk mund të importohet apo të përdoret pa lëshuar lejën përkatëse nga kjo ministri.

Andaj mbasi kryerja e shërbimeve të DDD do të bëhet brenda objekteve shkollore e veqanërisht në dhoma , shtretër të fëmijve parashkollore dhe bebave ku decidivisht është kërkuar të përdoren preparete në formë të GELLIT (preparate që nuk lirojne as erë dhe nuk kanë asnjë efekt rezidual). e jo preparate koncentrate që përzihen me ujë, përshak që këto produkte lënë mbetje që mund.të shkaktojnë probleme shëndetësore edhe me efekte afatgjata (sidomos te bebat). Pastaj është kërkuar Pllaka ngjitëse për minjë me aromë me qëllim të tërheqjes dhe kapjes së menjehershme të minjëve kur minjët të hyjnë në dhoma të fëmijve, mbasi urina (aroma) e minjëve është shum e rrezikshme për fëmijet (bebat.) Komisioni i Komunes së Prishtinës duke marur parasysh se ky projekt është i ndieshëm mbasi ka të bëj direkt me jetën e fëmijëve edhe pse tri herë ka analizuar këtë projekt dhe ka rekomanduar se ky OE nuk i plotëson kërkesat për realizimin e këtij projekti, ka larguar përgjegjësitë nga vetja dhe nese i ipet kontrata OE të lartshënuar kush do ti bartë pasojat që do të vijnë gjatë dhe pas realizimit të këtij projekti?

AK me rastin e ri-vlerësimit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 të LPP sepse i njejti ka qenë i detyruar të bëjë vlerësimin ,ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave, ne e kuptojmë zhgënjimin e zyrtarëve të AK-Komuna e Prishtinës me vendimin e OSHP, kjo vërehet në raportin e vlersimit dhe konstatimet e tyre se edhe përkundër që OE "VLERA SHPK dhe EKO DEZ DOO"është e pa përgjegjishme në bazë të vendimit të

OSHP duhet të rekomandojn për kontratë, AK ka qenë i detyruar edhe përkundër vendimit të OSHP të vertetoj gjendjen faktike të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë sepse ka një mal me prova se i njejti nuk ka plotësuar kërkesat teknike dhe profesionale dhe ato të përshtatshmërisë. Kjo konfirmohet nga të gjeturat në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë.

Po ashtu i njejti ka përdorë dokumentacionin e OE" EKO DEZ doo"pa pëlqimin e tij dhe dokumentacioni i përdorur është i modifikuar dhe i falsifikuar këtë e kemi vërtetuar gjatë bisedës me drejtorin e "EKO DEZ doo" i cili e konfirmoi se nuk jam në konzorcium me OE "Vlera"për këtë projekt dhe dokumentet e mija ja kam dhënë për një tender në Veri të Mitrovicës ai mbet i habitur me listën e paisjeve ku një pjesë është e shkruar në gjuhën shqipe e një pjesë në gjuhën serbe ku i njejti deklaroi se si ka mundësi të nënshkruaj dhe vulosi diqka në një gjuhë që nuk e kuptoj.
Nga kjo dyshohet se deklarata nën betim, marrëveshja e konzorciumit, deklarimet e antarit të konzorciumit bashkarisht dhe veq e veq, lista e paisjeve etj.....janë të falsifikuara nga ana e OE'Vlera".

Lidhur me këtë kemi kërkuar nga AK konform kompetencave dhe autorizimeve të kërkoj nga OE"EKO DEZ doo"sqarime lidhur me këto dokumente dhe të kërkoj nga OSHP konform nenit 99.2 të vendoset në listën e zezë.
Ne kemi informacione se i njejti ka vepruar në një aktivitet të prokurimit në qendrën e studentëve dhe pas kërkesës së AK Qendra e Studentëve nga OE"EKO DEZ doo"i njejti nuk ka dorëzuar dokumentet e kërkuara nga AK dhe OE"Vlera"është tërheq nga aktiviteti i prokurimit për ti evituar pasojat ligjore. JU njoftojmë kjo ka ndodh në fazën e ri-vlersimit pasi OSHP e ka kthyer lëndën në ri-vlerësim.
Ne kemi kërkuar me shkrim nga OE"Eko Dez doo" të na konfirmoj këto , por i njejti ka hezituar sepse ne ishim kompani dhe nuk ishim institucion publik për të kërkuar konfirmim me shkrim, andaj kërkuam nga AK-Komuna e Prishtinës që ti drejtohet në mënyrë zyrtare këtij OE për të konfirmuar këto dokumente, por AK nuk e bëri.
Tani kërkojmë nga ana e juaj si Organ me i larte të nërmerrni diqka në këtë aspekt.
Komunikimi me OE"Eko Dez doo" të bëhet në emailin zyrtar ekodezbgd@sezampro.rs i cili figuron në dokumentet e të njejtit, e-mail ky që figuron edhe në faqen zyrtare të kompanisë në internet www.eko-dez.info, pasiqë në platformen elektronike (E-prokurim), figuron një e-maili tjetër ekodezdoo@yahoo.com . Ne kemi dyshime në këtë e-mail i cili në e-prokurim është në emër të Vojislav Majstorovic, pasiqë në faqën zyrtare të kompanisë EKO DEZ DOO janë këto të dhënat për kontakt:
Kontakt email : ekodezbgd@sezampro.rs
Vojslav Majstorovic (direktor): voja@eko-dez.info

AK-Komuna e Prishtinës e detyruar nga OSHP me rastin e ri-vlersimit ka bërë shkelje të:
Paragrafi 4 i nenit 59 të këtij ligji, përcakton, citojmë:
"4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit "...

Gjithashtu, Paragrafi 3 i nenit 56 të LPP-së përcakton si në vijim:
"Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

AK pa dashjen e tij me rastin e e ri-vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 të LPP citat i nenit 1.1 të LPPës:
" 1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese,koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla".

AK me këtë ka vepruar në kundërshtim me nenin 7.6(v)dhe (vi) citat:" (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse."

Nga të cekurat më lartë të cilat janë evidente,të prekshme kërkojmë nga ana e juaj qe të shqyrtoni kërkesën tonë lidhur me tenderin :"Dezinfektimi, dezinsektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore "me nr.të prokurimit 616-19-1655-2-2-1 dhe të kthehet lënda ne ri-vlersim tek AK dhe e njejta të merr këtë:

VENDIM

1.Aprovohet si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e "Besim A.Zejnullahu B.I – "N.SH.EKO - DDD" lidhur me tenderin :"Dezinfektimi, dezinsektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore "me nr.të prokurimit 616-19-1655-2-2-1.

2.Anulohet njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me tenderin :"Dezinfektimi, dezinsektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore "me nr.të prokurimit 616-19-1655-2-2-1 dhe rekomandohet për kontratë"Besim A.Zejnullahu B.I – "N.SH.EKO - DDD" dhe lënda kthehet në ri-vlerësim.

Prandaj, kërkojmë nga OSHP-ja që këtë procedurë të prokurimit ta kthen në Rivlersim, ta anuloje Vendimin për shpërblim me kontratë dhe të vazhdon me këtë procedurë të prokurimit pasiqë kompania e jonë është e përgjegjshme konform kërkesave të DT dhe NJPK.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*